

## INFORMACION

PER EVIDENTIMIN E DISA PROBLEMEVE NE PROCESIN E TRANSFERIMIT TE PASURISE PYJORE NE NJESITE E QEVERISJES VENDORE

### Nga Ndriçim Çela.Kryetar I Bordit te SH.R.PKK. QE

Deshiroj te evidentoj disa dukuri qe jane vene re gjate procesit te transferimit te fondit pyjore ne NjQV per ta bere sa me rezultativ takimin,per te dialoguar dhe sugjeruar sebashku zgjidhjen e tyre.

Si fillim deshiroj te jap mesazhin e bashkepunimit dhe te mos e shohim njeri tjetrin ne gare per te rrembyer gjithsecili copen me te madhe dhe si kundertshtare te njeri-tjetrit,por ne jemi ketu per te bere avokacine e pasurise pyjore si dhe te gjithë burimeve te tjera natyrore ne te mire te komunitetit ne pergjithesi e te perdoruesit real ne veçanti.

1-Megjith arritjet ,ritmet e transferimit jane te ngadalta,sepse:

Aktoret pjesemarres nuk kane ndjere si duhet pergjegjesine qe kane ne realizimin e kesaj reforme te rendesishem ne kete sektor jetik per ekonomine dhe fermerin shqiptar.

Akoma nuk jane njohur ligjerisht kufijt midis fshatrave,midis Komunave por dhe midis rretheve.

Perdoruesit nuk kane asnje dokument qe te vertetojne te drejtat e tyre te perdorimit apo pronesise mbi ate pyll,kullote apo te ndonje burimi tjetër natyrore.

Asnje zyre e ZRPP nuk ka rregjistruar qofte dhe ne nje rreth te vetem transferimin e kesaj pasurie te madhe .

2-Ka mangesi ne kuadrin ligjore eksistues lidhur me te drejtat e pronesise e te perdorimit per pyjet dhe kullotat komunale e te burimeve te tjera natyrore si:

-perqendrimi I kopetencave ne organet shtetore edhe per ceshtje qe duhet ti takojne NjQV si menaxhimi dhe administrimi I pyjeve e kullotave dhe per burimet e tjera natyrore.

-ka mosperputhje e mbivendosje kopetencash midis disa ligjeve per administrimin dhe kadastrën e pyjeve dhe kullotave komunale,per kundervajtjet,lejet mjedisore,gjobat dhe sidomos vjeljen e tyre.

-te drejtat e perdorimit nuk jane te plota e te qarta per pyjet dhe kullotat qe jepen ne perdorim fshatit dhe familjeve sepse mungojne dispozitat ligjore.

Nuk mund ta zgjidhi problemin vetem VKM nr 22 date 09.01.2008 sepse ai eshte nje vendim qe jep urdher per tu zbatuar por nuk eshte ligj I sanksionuar.

-Nuk eshte perdor I njeiti mates per transferimin e pasurise pyjore ne njesite e qeverisjes vendore.

Psh. Ne rrethin e Elbasanit vetem 4 Komuna nuk i kane marre ne pronesi Pyjet dhe kullotatat komunale .

Çfare ligji eshte perdor per keto komuna.

Sipas vendimit te KM nr 1077 date 18.06.2008 qarku I Elbasanit ven ne dispozicion te Agjensise te Kthimit e te kompensimit te pronave 6464 ha pyje prodhues dhe po sipas ketij vendimi 1868 ha merren nga fondi pyjore I nje Komune , shifer kjo e barabarte me 51% te tere fondit prodhues te pasurise Pyjore qe ka ka ne teritorin e saj kjo Komune ose 29 % te totalit te qarkut qe per mendimin tone kjo nuk eshte e drejte por e penalizon kete njesi te qeverisjes duke I rrembyer gjysmen e pasurise pyjore.(ajo ka 3551ha pyje +180ha Kullota. Behet fjale per Komunen Paper-Elbasan)

Si ky rast ka dhe NjQV te tjera por me dukuri te ndryshme.

Komunave malore me pyje pishë mesdhetare(objekte pyllezimi),cungishte lisi te zhvilluar u eshte hequr e drejta e perdorimit duke I lene nje siperfaqe te konsiderushme shtetit.Keshtu ndodh ne Gjinar Shushishice Gracen,Labinot Mal,Funar,Tunje,Skenderbegas

Administrimi I ketyre siperfaqeve behet nga shteti por ligji si e parashikon kete çeshtje.dhe a eshte i drejte ky veprim?

Çfare perfiton fermeri qe banon rreze ketyre maleve te larte e lendinave te bukura????

Kush duhet te hyje ne ekonomine e tregut shteti apo fermeri??Çfare thote eksperinca e vendeve fqinje dhe e atyre te zhvilluara per kete qellim.

A eshte ky nje problem qe duhet te marre zgjidhje nje here e mire.

**Eshte e vertete qe shteti duhet te jete I fuqishem por ai nuk mund te marre fuqi me fermere te pafuqishem per te hyre ne ekonomine e tregut.**

Te banosh prane maleve dhe lendinave dhe te privohet e drejta e kujdesit,dhe e vjeljes se ardhurave te tyre eshte njelloj sikurse I privohet e drejta e mbajtjes se gjese gjalle nga diktatura komuniste fshatarit te Malit te Vashes nga ku shiheshin kullotat e Sopotit dhe fshati Vasjan te kenges se Isuf Myzyrit.

Komuna Rrajce ka probleme me pronesine,po keshtu Komuna Stebleve,Hotolisht ,Tunje etj.

Prandaj po ritheksojme se “te drejtat e perdorimit nuk jane te qarta dhe te plota per te gjithë pasurine pyjore ne kuptimin e gjere te fjales”sepse mungojne dispozitat ligjore,kriteret dhe rregullat e menaxhimit dhe te shitjeve te materialeve drusore e jo drusore nga perdoruesit dhe shoqatat me qellim rritjen e te ardhurave te tyre.

-mungojne kriteret per kalimin e pasurise pyjore nga perdorimi ne pronesi te perdoruesve.(ata dine dhe I ruajne edhe vete por kriteret ligjore jane te domosdoshme)

-mungon rregullimi me ligj I marredhenieve midis qeverise qendrore dhe NjQV ,midis NjQv dhe perdoruesve(Fshat fis familje) dhe te sherbimit pyjore e pronaret private,

Pra nuk ka struktura lidhese per keto probleme.

-Mungojne kompensimet qe duhet te marrin perdoruesit dhe shoqatat per kufizimet qe behen nga ligjet per parqet kombetare,zonat e mbrojtura,pasurite ujore,minerale,zonat turistike deri dhe ushtarake qe ndodhin ne teritorin e tyre.

Shoqata Rajonale e Pyjeve dhe e Kullotave Komunale QE edhe ne takimet e tjera Lokale si ato qe u zhvilluan ne muajin shkurt 2008 me nismen e Kryetarit te Keshillit te qarkut z.Ardian Turku dhe zyres se kordinim zhvillimit prane Qarkut Elbasan e ka ngritur zerin per keto probleme.

Por ka nje kontradikte teper interesante qe ne fakt nuk duhej te ishte

Ekziston prane qendres nje lob konservatore qe I mbyll problemet dhe llogjikon se jane ata me afer pasurise pyjore me te gjithë perbersit e saje,dhe po nuk u be ashtu si thone ata pasuria pyjore u shkaterrua.

.Por ekziston dhe nje lob tjeter qe eshte me tolerant dhe me liberal ne gjykimin e tije qe thote se me afer se kushdo me pyjet , kullotat dhe çdo burim tjeter natyrore eshte fermeri me ineresat e tije .

Shoqata e Pyjeve dhe Kullotave Komunale Qarku Elbasan vlerson lobin liberal qe kerkon decentralizimin e pasurise pyjore per tu rritur e zhvilluar me tej kjo pasuri por per te nxjerre dhe pergjegjesit e paleve ku rregullatori kryesor eshte shteti nepermjet ligjit.

Pra nuk ka pse te ndihet fjala vjen Ministri apo drejtori pronar kur dihet se ata jane vetem kalimtare ne detyrat e tyre e te mos ndihet pronar fermeri qe banon dhe I sherben kesaj pasurie me shekuj.

Shembuj te ruajtjes dhe te zhvillimit te pyjeve dhe te pasurive tjera natyrore ne keto dy dekada ka shume .

Hidhni nje sy grykes Shkumbimit dhe shikoni se si eshte rritur e zhvilluar pylli, hidhni nje sy kalimit te ujrave te kthjellta e te embla dhe shikoni se si eshte zhvilluar trofta ne rezervatet private etj.

Ne vazhden e ndikimit te shume aktiviteteve qe jan zhvilluar ne kuadrin e Transferimit te Pasurise Pyjore ne Nj.Q.V. pa I paragjykuar DSHP se edhe ato kane bere shume pune ne kushtet e nje mungese experience dhe te nje kuadri ligjore te plote ne shume komuna jane bere dhe gabime.

Keto gabime kane ardhur si pasoje e pregatitjes se njeanshme te dokumentacionit nga DSHP.

Shume kryetare Komunash firmosen Proces-Verbalin e transferimit pa I shkelur me kembe e pa I pare me sy parcelat ose me mir Pasurine pyjore qe do te merrnin ne pronesi. Kjo edhe sepse kryetaret e Komunave nuk e njihnin mire gjendjen por dhe nuk jane specialiste pyjesh.

Prandaj jemi sot ne nje suate hidh e prit si thote populli.

Natyrisht nje informacion nuk mund te evidentoje te gjitha problemet shqetsuese, te pazgjidhura gjate ketij procesi te thelle reformash.

Por ajo qe eshte e rendesishme per ne duhet te jete dhe per aktoret e tjere qe marrin pjese ne realizimin reformes ne pyje dhe ne teresi te burimeve te tjera natyrore.

Siç thame dhe ne fillim ne nuk duhet ta shohim njeri tjetrin si kundërshtarë që jemi në një garë se kush do të marrë copën e madhe. Te gjitha palet duhet të bëjnë avokaci për perdoruesit real të pasurisë pyjore. Ky është roli jonë sot

Ne nuk duhet te flasim me dy gjuhe, te permbushim dy pale interesa, te hartojme dy ligje, te bejme dy marrveshje. Jo.

Ne duhet te flasim me gjuhen e ligjit per pyllin, te permbushim interesat rajonale ne perputje me strategjine e zhvillimit kombetare.

Te hartojme nje ligj per pyjet qe ti rezistojte kohrave dhe te bejme nje marrveshje se te gjithë punojmë për pyjet, kullotat, mjedisin dhe çdo burim tjetër natyrorë.

Te gjitha keto arrihen kur bashkepunimi vihet në çdo pikë të programeve të punës të në pozicionet ku kemi aktivitet.

Duhet gjetur rrugë për të administruar pasurinë pyjore atje ku ka vendin.

**Ne nuk duhet te mbetemi ne konstatimin qe eshte njekohesisht dhe thirrje per ne edhe sot te botanistit dhe themeluesit te flores per Shqiperine Antonio Baldacci ketu e nje shekull me pare I cili theksonte :'' rilindja e bujqesise qe mund te perbeje ne vetvete nje monument te historise per nje qeveri eshte e lidhur edhe me problemin e Pylltarise. Por ka nje veshtiresi theksonte ai:'' qe eshte vertetimi I pronesise se Pyjeve te Shqiperise. Parasegjithash duhet stabilizuar se cilat jane ne pronesi private, cilat ne perdorim te perbashket e cilat shtetore dhe kjo per te shmangur kundërshtimet qe lindin me mijera dhe nxjerrin veshtiresi qe nuk do te jete lehte per tu kapercyer nga qeveria. (marre nga libri 'Rrugetime Shqiptare''1892-1902)**

Difektet në ligjin nr 7501 date 19.07.1991 nuk duhet të perseriten për ligjin e ri për pyjet.

Te gjejme kodet mijevecare (sepse jane te pashkruara por qe veprojne dhe sot e kesaj dite) te krijuara nga komuniteti ne rjedhen e shekujve per adminstrimin e pasurise pyjore. Mendimi I strukturave te nivelit te pare te NjQV,Shoqatat e PPKK dhe perdoruesit reale eshte:

-Krijimi urgjent I strukturave ne zbatim te VKM nr 22 date 09.01.2008

-Te forcohet bashkepunimi midis ketyre strukturave (NjQV.-SHPPKK-DSHP)per lehtesimin e procesit te transferimit te pyjeve dhe te kullotave komunale ne menyre organike d.m.th te shkoje haka tek I zoti.

Sepse ne nuk mund te mohojm arritjet ne procesin e transferimit te pasurise pyjore por duhet te pranojme se jemi te vonuar ne realizimin perfundimtare te ketij procesi.

Qeveria me vendimet e marra ka kryer vetem kalimin formal te pasurise pyjore ne NjQV por ketij veprimi nuk u eshte qepur nga mbrapa aktiviteti ligjore I shume strukturave te tjera shtetore sic eshte ai I Agjensise te inventarizimit dhe regjistrimit te pronave te palujtshme,I ZRPP,dhe I aktoreve te tjere pjesemarres te rendesishem ne realizimin e kesaj reforme .Se kesaj I thone ‘‘Shteti e dorzoi pyllin, komuniteti nuk e ka marre.Pylli ngelet pa zot’’

Per te perfunduar ne mendojme qe te zgjidhim sebashku keto pergjegjesi

1-Ne strategjine rajonale , sektori I pyjeve dhe I kullotave te zere vend me perparesi.dhe ne perputhje me strategjine e zhvillimit kombetare.

Hartimi I nje programi Rajonal per Pyjet dhe Kullotat Komunale mbetet nje nder detyrat me urgjente te stukturave perkatese dhe te Shoqates Rajonale te PKK QE.

Ne kete program duhet te perfshihen objektivat e transferimit te pasurise pyjore si dhe strategjia e reformave,roli I shtetit,I qeverisjes vendore dhe I perdorueseve (fshat, familje,shoqate)ne mbareshttrimin e pyjeve dhe kullotave te veta .

2-Do te ishte me vend permirsimi I kuadrit ligjore dhe ne to te parashikohen;

a-legalizimi dhe njohja e te drejtes te pronesise tradicionale te pasurise pyjore per pretenduesit reale(pronaret) dhe perdoruesit faktike (familja ,fshati,shoqata) dhe keto te paisen me dokumente ligjore nga ZRPP.

b-e drejta e mbarshtrimit e te gjitha pasurive natyrore qe eshte nen juridiksionin e NjQV(kafshe te egra,burime uji,perrenj,rezervuare vendore,lendet inerte, e peshku ,edhe blea pse jo)

c-kalimin e specialisteve perkates,te fondeve,mjeteve e paisjeve te nevojshme nga sherbimi pyjore ne komuna,perpjestimisht me siperfaqen qe kalon,si dhe I dokumentacionit kadastral,teknik e hartografik.

ç-te drejten e perdoruesit(fshati,familja,shoqata)per shitjen e prodhimeve mbi nevojat e veta,si dhe per te shfrytezuar pyje e kullota shtetore per te nxjerre prodhime per shitje dhe sigurim te ardhurash per zbutjen e varferise,krahas krijimit te instrumentave finaciare dhe nxites per te mbeshtetur zhvillimin e pyjeve dhe te kullotave komunale,si dhe te pasurive te tjera natyrore ne zonat rurale.

d-ne aktet ligjore duhet te behet dallimi midis pyjeve e kullotave qe mbareshtrohen nga komuna per plotesimin e funksioneve te veta(pasi te jene plotsuar nevojat e banoreve)per pyjet dhe kullotat komunale qe administrohen nga fshati,familjet bujqesore,shoqata.

Eshte e nevojshme te rishikohen kriteret per pyjet e kullotat e te cdo burimi tjetër natyrore qe kalohen ne pronesi.

Çdo fshat te kete pronat e veta mbi pasurite natyrore.

Planet e mbarshtrimit te hartohen e zbatohen ne baze fshati dhe permbledheset per Komunen.

e-te krijohet dhe te funksionojë sa me shpejt te jete e mundur sherbimi keshillimor pyjor,veçanerisht per pylltarine Komunale.

f-gjate permirsimit te kuadrit ligjore te kihet parasysh perputhja midis ligjeve te ndryshme duke I pare ne teresi e unitet dhe tendenca te jete perafrimi me ligjshmerine europiane e pse jo dhe botrore.

g-permirsimi I kuadrit ligjore ti nenshtrohet nje pjesemarrjeje te gjere te institucioneve e personave te interesuar,te perfaqesueseve te NjQV,te shoqatave dhe sidomes te perdorueseve.

h-megjithse eshte nje kohe e shkurter e miratimit te ligjit per pyjet nga Parlamenti Shqiptare ne arrijme ne konkluzionin se ai ligj nuk I parashikon te gjitha zgjidhjet per vete reformen qe po kalojne Pyjet dhe pasurite e tjera natyrore.

Shoqata Rajonale e Pyjeve dhe Kullotave Komunale Qarku Elbasan propozon hartimin e nje ligji te ri me 3 krere kryesore.

1- mbarshtrimi I pyjeve shtetore ne administrim te sherbimit pyjore.

2-mbarshtrimi I pyjeve dhe I te gjitha pasurive Natyrore ne pronesi te NJQV dhe te perdorueseve tradicionale mbrenda juridiksionit te tyre.

3-mbarshtrimi I pyjeve private.

Ju faleminderit.